



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:251656

Datë: 23.01.2025

Numri i dokumentit: 06749009

**C.nr.4097/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,** gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me praktikanten L.B. në çështjen juridike kontestimore të paditëses K.N. me numër personal .... nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson Av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria për Arsim në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja ligjore V.I.Xh. me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguara, vlera e kontestit 885.60 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 23.01.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

**I. APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses K.N. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria për Arsim në Prizren, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguara. **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria për Arsim në Prizren, që paditëses K.N. në emër të kompensimit të kualifikimit nga marrëdhënia e punës, për periudhën kohore prej datës 01.10.2021 deri më datë 31.01.2023 apo për 16 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë - 421.00 euro, në emër të kompensimit të kualifikimit nga marrëdhënia e punës, t’ia paguajë shumën prej 885.60 (tetëqind e tetëdhjetë e pesë euro e gjashtëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 07.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria për Arsim në Prizren, që paditëses K.N. t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja K.N. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria për Arsim në Prizren, me objekt kontesti kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguara.

I autorizuari i paditëses në padi, ka theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse pranë shkollës SHFMU “Mid’hat Frashëri” në Krajk, Komuna e Prizrenit, ku ka punuar dhe vazhdon të punojë në këtë institucion. Paditësi me datë 09.02.2024 ka bërë precizimin dhe plotësimin e padisë në aspektin objektiv sa i përket vlerës së kontestit, me anë të precizimit të padisë paditësi ka kërkuar që kompensimi për kualifikim – licencim ti njihet nga data 01.10.2021 deri me datë 31.01.2023, pra gjithsej për 16 muaj. Tutje, ka theksuar se duke llogaritur periudhën kohore prej 01.10.2021 deri me 31.01.2023, për 16 muaj, paditëses i ka takuar e drejta e kompensimit për 27% të vlerës së pagës bazë, në bazë të nivelit të shkollimit, bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës dhe Vendimit të Qeverisë nr.01/33 të datës 29.08.2008, e që deri tani në emër të kualifikimit paditëses i është paguar vlera prej 58.32, ndërsa në bazë të përgatitjes profesionale është dashur të paguhet 113.67 euro, pra që vlera prej 55.35 euro nuk ju ka paguar fare paditëses. E njëjta për 16 muaj pune nga data 01.10.2021, e deri me datë 31.01.2023, janë bërë 16 muaj, të cilat shumëzohen me 55.35 euro del shuma e përgjithshme prej 885.60 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë. Andaj, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e paditëses, të detyrohet e paditura t’ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 885.60 euro, në emër të kompensimit të kualifikimit nga marrëdhënia e punës, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 104 euro për përpilimin e padisë, 104 euro për precizimin e padisë dhe 30 euro për taksë gjyqësore, e në shumë të përgjithshme prej 238.00 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimet e paditësit se i takon kompensimi deri më 31.01.2023, janë të pabazuara për arsye se në mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023, e datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet trajtuar deri më 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese dhe se pretendimet e paditëses se i takon kompensimi për kualifikim dhe licencim janë në kundërshtim me nenin 2 par.1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, pasi përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësja në padi nuk paraqet fakte se është anëtarë e kësaj sindikate, nuk e dëshmon me anë të kartelës së anëtarësisë. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, janë në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja K.N. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse në shkollën SHFMU “Mid’hat Frashëri” në Krajk, Komuna e Prizrenit. Kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit përkatësisht diferencës konkrete të pa paguar.

Gjykata përmes kontratës së punës nr. protokoli 16 e datës 20.10.2015, vërtetoi faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se kualifikimi i paditëses është me fakultet baçelor i programit fillor. Po ashtu, një fakt i tillë vërtetohet edhe nga diploma e lëshuar nga Fakulteti i edukimit – Qendra në Prizren, me numër 1297, e datës 19.09.2018, lëshuar në emër të paditëses ku e njëjta ka marrë titullin baçelor i programit fillor, ndërsa nga vërtetimi nr.298/2023 datës 05.12.2023 vërtetohet se paditësja tek e paditura është në marrëdhënie pune nga data 01.09.1997 dhe vazhdon.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj, meqë këto dokumente, përkatësisht kontrata e punës, licenca dhe lista e pagave janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë

(Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia bëjë kompensimin e kualifikimit nga marrëdhënia e punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 58.32 euro paditëses. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja për periudhën 01.10.2021 deri më datë 31.01.2023 përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur, për 16 muaj nga data 01.10.2021 deri më datë 31.01.2023, në shumë prej 885.60 euro sipas ( $55.35 \times 16 = 885.60$  euro), që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 885.60 euro duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro, mbi këtë bazë gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 07.11.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën

Numri i lëndës: 2023:251656  
Datë: 23.01.2025  
Numri i dokumentit: 06749009

prej 30.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara lidhur me plotësimin e padisë në vlerë prej 104 euro, pasi që gjykata ka njohur shpenzimet për përpilimin e padisë e cila me paraqitjen në gjykatë duhet të jetë e caktuar dhe precizuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim lidhur me nenin 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.4097/2023, datë 23.01.2025**

**Gjyqtari**

---

**Taulant Rexhëbeqaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.